



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Ministria e Bujësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, forestry and rural Development



Broshura:

“MBROJTJA E PEMËVE BËRTHAMORE NGA SËMUNDJET DHE DËMTUESIT SIPAS FAZAVE TË ZHVILLIMIT”



KOSOVA DEVELOPMENT CENTER
QENDRA KOSOVARE PËR ZHVILLIM

Address: Dëshmorët e Lirisë nr.135 Gjakovë-Kosovë
Tel: +383 38 724 499 Email: kdc.gjakov@yahoo.com

www.kdc-kosova.org

Hyrje:

Kjo Broshurë është përgaditur nga Ekipi i ekspertëve të Qendrës Kosovare për Zhvillim (KDC), në kuadër të projektit "Trajnimi i Kandidatëve Potencial për aplikim në programin e granteve për Zhvillim Rural" e mbështetur nga:MBPZHR dhe ARDP . Kjo broshurë shërben si doracak për nevojat e fermerëve të cilët merren me prodhimtari të pemëve frutore (bërthamore) si Kumbull, pjeshkë, nektarinë, qershi dhe vishnje, për identifikimin më të lehtë të sëmundjeve dhe dëtuesve si dhe për metodat e mbrojtjes.

Në këtë broshurë janë përshkruar dëmtuesit kryesor dhe sëmundjet më të shpeshta të këtyre pemëve, si dhe masat mbrojtëse ndaj tyre që nga faza e pas përfundimit të lulëzimit.



Shtator, 2020

Dëmtuesit (insektet) kryesor te pemët bërthamore

Afidet

Pemët frutore bërthamore preken zakonisht nga një numër i madh afidesh. Pjeshka dhe nektarina janë të ndjeshme ndaj shumë specieve të afideve (Myzus, Brachycaudus, Hyalopterus ecc.), qershia preket pothuajse vetëm nga Myzus cerasi, specie të ndryshme prekin kumbullën dhe më pak preket kajsia. Për luftimin me sukses të tyre, është i rëndësishëm identifikimi i saktë, sepse çdo specie ka veçoritë e saj biologjike (numrin e breznive, stadin e dimërimit, ciklin e zhvillimit, bimët pritëse primare e sekondare, kohën e shfaqjes), simptomat dhe demin (kolonitë).



Fotot: Morrat e gjetheve (afidet)


Masat mbrojtëse

Morrat e gjetheve duhet trajtuar me insekticid sistemik i cili lëvizë nga lartë poshtë ku në saje të kësaj lëvizshmërie arrijnë në gjitha organet e bimës . Trajtimet kryhen në disa faza varsisht nga kultura. Trajtimi fillestarë me rastin e formimit të sythave.

Movento është insekticidi i vetëm me veprim sistemik të dyfishtë; lëviz në drejtimin lart dhe poshtë. Movento, në sajë të lëvizjes së dyfishtë hyn në sistemin e qarkullimit dhe arrin në të gjitha organet e bimës: gjethe të reja dhe të zhvilluara, sytha, fruta dhe madje edhe rrënjë.

Breshkëzat

Pemët frutore preken nga breshkëza të ndryshme. Më të rëndësishme janë : - Breshkëza e Kalifornisë (Quadraspidiotus perniciosus), e cila prek pemët frutore bërthamore e farore. Ka 3 brezni në vit. - Breshkëza e bardhë e pjeshkës (Pseudaulacaspis pentagona) që prek kryesisht pemët frutore bërthamore. Ka 2-3 brezni në vit. Dëmi shkaktohet nga shpimet gjatë ushqimit. Prekjet shkaktojnë, tharje, dëmtim të degëve dhe njolla të kuqe në fruta.



Fotot: Breshkëzat (dukja në organet e pemëve) dhe forma e imagos (insektit të rritur)

Këpushat

Këpushat më të dëmshme për pemët frutore bërthamore i përkasin familjes tetranikide (*Panonychus ulmi*, *Tetranychus urticae*). Dëmi shkaktohet nga boshatisja graduale e parenkimës së gjetheve si rezultat i thithjes nga këta dëmtues. Gjethet marrin ngjyrë bronxi dhe dëmtohet prodhimi në sasi e cilësi. Për mbajtjen nën kontroll të këtyre dëmtuesve, është thelbësore ruajtja e armiqve të tyre natyrorë.



Fotot: Këpusha (imago) dhe demet në gjethe

Programi i mbrojtjes: Aplikohet insekticid (psh MOVENTO) i cili mund të perzihet edhe me vaj mineral, në fazën e pas lulësimit kur insektet (larvat) fillojnë migrimet e para. Doza: 150ml/100 L ujë (1.5-2.2 L/ha)

Cidia molesta

Është dëmtuesi "kyç" për pjeshkën, por prek gjithashtu edhe bërthamoret e tjera, si dhe farorët e bimët zbukuruese (trëndafilat). Ka 4-5 breznitë në vit. Fluturimi i parë i insektit të rritur fillon në pranverë dhe arrin pikun në fund të prillit - fillim i majit. Larvat e breznisë së parë prekin kryesisht lastarët, kurse ato të breznive pasardhëse kryesisht frutat. Prekje të mëdha mund të vërehen gjithashtu në farorë në kohën e pjekjes së frutave.



Foto: *Cydia molesta* dhe *Cydia funebrana* (insektet e rritura)

Cidia funebrana

Është dëmtues "kyç" për pjeshkën, por mund të prekë edhe pemët e tjera bërthamore. Ka 1 deri në 3 breznitë, në vartësi të zonës së shpërndarjes. Fluturimi fillon nga mesi i prillit deri në fillimin e majit. Larva penetron shpejt në

fruitat e vegjël të cilët mund të bijen. Breznitë pasardhëse shkaktojnë dëme të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë si kalbëzimim gri.

Programi i mbrojtjes: Mbrojtja duhet bazuar në monitorimin epopullatës me kurthe seksuale. Momenti i ndërhyrjes ndryshon në varësi të produktit të përdorur dhembrojtja mund të integrohet me metodën e konfuzionit seksual. Koha e trajtimit me insekticide (p.sh Decis): nga fillimi i fluturimit, deri në fillim të vendosjes së vezëve
Doza: 40-50 ml/100 L ujë (0,4-0,5 L/ha)

Tenja e pjeshkës (*Anarsia lineatella*)

Dëmet e para duken me fillimin e vegjetacionit kur larvat që dalin nga mbulesat dëmtojnë sythat. Dëmi është i ngjashëm me atë të *Cydia molesta* por ndodh 2-3 javë më shpejt.



Programi i mbrojtjes: Luftimi fillon në fazën e qeljes së vezëve me insekticide (p.sh. Calypso). Doza: 30 ml/100 L ujë. Trajtimet mund të perseriten sipas nevojës dhe gjendjes në plantacion.

Mizat

Janë dy lloje mizash që dëmtojnë bërthamorët:

Miza mesdhetare (*Ceratitis capitata*) - prek pemë të ndryshme si kajsi, pjeshkë, kumbull, agrume dhe pemët frutore farore;

Miza e qershisë (*Rhagoletis cerasi*) - prek kryesisht qershinë . Larvat e të dy llojeve zhvillohen brenda tulit të frutave duke kompromentuar rritjen e tyre, cilësinë dhe tregëtimin.



Foto: Miza mesdhetare dhe miza e qershisë

Dëmtojnë lulet dhe frutat e vogla të nektarinës dhe kultivarët e pjeshkës me pak push në sipërfaqe. Toksinat që injektojnë me pështymën shkaktojnë deformime dhe dëmtime që më vonë nekrotizohen dhe tapëzohen. Frutat e nektarinës, për shkak të mungesës së pushit, janë më të ekspozuar. Dëmtimet shkaktohen duke filluar nga faza e butonit rozë deri në afërsi të pjekjes. Llojet më të zakonshme janë Thrips meridionalis, Thrips major, Thrips tabaci dhe Frankliniella occidentalis; kjo e fundit dëmton kryesisht para vjeljes.

Programi i mbrojtjes: Përdoret insekticid (si psh. Decis) , nga koha nga fillimi i fluturimit, deri në fillim të vendosjes së vezëve Doza: 40-50 ml/100 L ujë (0,4-0,5 L/ha).

Sëmundjet kryesore të pemët bërthamore

KLADOSPORIOZA E BËRTHAMOREVE

Cladosporium carpophilum Thum.

Simptomatologjia

Kjo sëmundje prek gjethet, degët dhe sidomos frutat e bërthamoreve, midis të cilave në mënyrë të veçantë pjeshkën.

Mbi gjethe infeksioni vihet re rrallë dhe shfaqet me njolla me ngjyrë kafe-zezë, në vendin e të cilave sipërfaqja thahet. Lezionet mbi degë janë mjaft të ngjashme me ato të fletëbirueses, por mund të dallohen nga kjo e fundit nga fakti se janë më të mëdha dhe më të thella, me ngjyrë gritë errët. Qendra e njollave është më e ngritur dhe dallohet me sy një masë e zezë e përbërë nga organet e riprodhimit të kërpudhës.

Mbi fruta, sëmundja shfaqet zakonisht vonë në formën e njollave të vogla të errëta, sipërfaqësore, që tentojnë të bashkohen deri sa prekin pjesën më të madhe të sipërfaqes së frutit. Në këtë pjesë të infektuar fruti nuk rritet rregullisht.

Masat e luftimit

Lufta kundra kësaj sëmundjeje bazohet në luftimin e formave dimëruese të patogjenit. Trajtimet dimërore me Ziram, Tiram, Captafol kundër fletëpërdredhjes dhe fletëbirueses janë të vlefshme edhe për kladosporiozën.

Në rastet kur vihen re dëme mbi fruta, mund të ndërhyhet me preparate me bazë Squfuri, Ziram, Captafol, Folpet, Tiram, Triforinë. Trajtimet mund të përsëriten në interval 10-12 ditësh. Krahas trajtimeve, në kohën e krasitjes duhet të hiqen dhe shkatërrohen degët që shfaqin shenjat e sëmundjes, për të paksuar masën e inokulit të pranishëm në pjeshkore.



Foto: *Cladosporium carpophilum* Thum.

KANCERI I BERTHAMOREVE

Fusicoccum amygdali Delacroix.

Simptomatologjia

Simptomat e kësaj sëmundjeje të rrezikshme mbi pjeshkë dhe bajame shfaqen zakonisht gjatë muajve të pranverës dhe verës në formën e lezioneve eliptike, me ngjyrë kafe-lajthie, lehtësisht të shtypura, zakonisht të vendosuar në afërsi të sythit. Në pjesët e nxira, indet kortikalë nekrotizohen, plasariten dhe mbulohen nga eksudati gomoz. Me

kalimin e kohës, indet e nekrotizuara shfaqen të mbuluara nga pikëza të vogla me ngjyrë të zezë, që përfaqsojnë organet e riprodhimit të patogjenit, piknidet.

Në vitin e parë të sëmundjes, bima i zëvendëson degët e thara me të tjera, por me kalimin e kohës ajo dobsohet në mënyrë progresive.

Disa herë sëmundja arrin të preki edhe degët e trasha, në formën e kancereve të lëkurës, të theluara deri tek druri.

Masat e luftimit

Mbrojtja ndaj kësaj sëmundje duhet të sigurohet me masa të përshtatëshme agronomike (vaditjet vetëm nën kurorë, vaditje me norma uji të kontrolluara, përdorimi i kultivarëve pak të ndjeshëm dhe tj.), me ndërhyrjet profilaktike (heqja e degëve të infektuara etj) si dhe me trajtimet kimike të destinuara për mbrojtjen e bimëve në periudhat e ndjeshmërisë së lartë ndaj sëmundjes.

Në rastet më të rënda, duhet të kryhen trajtime suplementare në vjeshtë, duke i filluar ato shumë shpejt (që nga fillimi i rrëzimit të gjetheve të para, në fund të shtatorit) dhe të përsëriten 2 - 3 herë (deri pas rrëzimit komplet të gjetheve, në mes të nëntorit). Fungicidet që mund të përdoren mund të zgjidhen midis atyre me veprim preventiv si: Captofol, Dithianon ose me veprim kurativ si Benomyl, Carbendazim, Tiophanat - metil.

NDRYSHKU I BERTHAMOREVE

Tranzschelia pruni-spinosae (Pers.) Dietel.

Tranzschelia pruni-spinosae është një ndryshk, me forma të ndryshme specializimi, që zhvillohet mbi specie të ndryshme bërthamore. Në veçanti, *T. pruni-spinosae* var. *discolor* prek pjeshkën dhe specie të tjera frutore të gj. *Prunus*, ndërsa *T. pruni spinosae* var. *pruni spinosae* infektion kumbullën dhe specie të egra të gj. *Prunus*. Në pjeshë kjo sëmundje nuk merr ndonjë rëndësi të veçantë.

Simptomatologjia

Infeksioni nga ndryshku prek gjethet, duke filluar nga ato të degëve më të ulta dhe, mjaft rrallë frutat.

Gjethet e prekura shfaqin njolla të vogla klorotike dhe pastaj, sidomos mbi faqen e poshtme, pustule me ngjyrë kafe, në formë të pluhurit, nga të cilat çlirohen uredosporet. Në fund të vegjetacionit, pustulet marrin ngjyrë të zezë dhe prej tyre çlirohen teleutosporet.

Frutat preken rrallë nga kjo sëmundje.

Dëmi nga kjo sëmundje qëndron në faktin se prania e pustulave të ndryshkut mund të provokojë një rënie intensive të gjetheve të bimës, që bëhet më e ndjeshme nga veprimi i patogjenëve të tjerë. Bimët e prekura në formë të rëndë, nxjerrin një fluks të bollshëm gomoze edhe në sezonin e ardhshëm.

Masat e luftimit

Në pjeshkë dhe kajsji, ku infeksioni shfaqet zakonisht vonë dhe shkakton dëme të vogla direkte, trajtimet shpesh rezultojnë të panevojshme. Ndërsa në kumbull, sidomos në kultivarët europianë, luftimi nganjëherë bëhet i domosdoshëm, kur dëmet janë të mëdha, sidomos në rastet e dobësimeve të forta të degëve të çveshura para kohe nga gjethet.

Zakonisht është i mjaftueshëm një trajtim, menjëherë pas shfaqjes së pustulave të para mbi gjethe. Fungicidet e përdorura kundër ndryshkut të bërthamoreve janë: Captan, Folpet, Ziram, Clorotalonil, Triforinë, Ditianon, Captafol.

Foto: Ndryshky (Gjethi)



NDRYSHKU I QERSHISË

Puccinia cerasi (Bereng.) Cast.

Simptomatologjia

Kjo sëmundje prek me preferencë qershinë, por dëme shkakton edhe mbi shumë pemë të tjera frutore bërthamore si të kultivuara ashtu dhe spontane.

Simptomat janë të ngjashme me atë të ndryshkut të bërthamoreve. Ato dallohen nga ngjyra dhe shpërndarja e pustulave, që nuk janë pothuajse kurrë të izoluar. Organet e prekura nga kjo sëmundje janë gjethet, në faqen e poshtme të të cilave, shfaqen pustula të bardha ose të verdha të vendosura në grupe shumë afër njëri-tjetrit, që tentojnë të bashkohen. Një infeksion i rëndë nga kjo sëmundje shkakton një ulje të vogël të rezistencës së bimës ndaj patogjenëve të tjerë.

Masat e luftimit

Kundër kësaj sëmundje nuk kërkohen trajtime kimike specifike. Në rastet e domosdoshme, mund të kryhen dy trajtime preventive me zineb, para lulzimit dhe rreth 20 ditë para pjekjes së frutave.



Foto: Teleutopustulet dhe uredopustulet e ndryshkut të qershisë

DEFORMIMI I KOKRRAVE TE KUMBULLËS

Taphrina pruni (Fuckel.) Tul.

Simptomatologjia

Kjo sëmundje prek specie të ndryshme të gjinisë *Prunus*, midis të cilëve në veçanti kumbullën. Sëmundja edhe pse fillon mbi lule, bëhet e evidente vetëm kur frutat kanë arritur një farë shkalle zhvillimi. Frutat e infektuar, në vend që të marrin pamjen e frutave normale, deformohen thellë duke marrë forma të ndryshme, disa herë të zgjatura, në raste të tjera përkulen në formën e një çante. Shpesh ai është i mbuluar nga një myk i bardhë i përbërë nga organet e riprodhimit të kërpudhës. Frutat e transformuar në këtë mënyrë, mund të rrëzohen para kohe, por shpesh thahen (mumifikohen) dhe mbeten në degë deri në pranverën e ardhshme.

Masat e luftimit

Rekomandohet prerja dhe shkatërrimi i degëve që mbajnë frutat e mumifikuara. Në rastet kur pranvera është shumë e lagët mund të rezultojë i nevojshëm një trajtim preventiv në fillim të vegjetacionit me Oksiklorur bakri, Ziram ose Tiram. Duhet theksuar se trajtimi dimëror i kryer në kohën e rënies së gjetheve me lëng bordolez ose me ditiokarbamate si dhe me Polisulfur kalçiumi në kohën e fryrjes së sytheve, është efikase edhe kundër këtij patogjeni. Në foton në vijim janë paraqitur simptomat e *T. pruni*



VERTICILIOZA

Verticillium albo-atrum Reinke et Bert.

Verticillium dahliae Kleb.

Simptomatologjia

Verticilioza është një sëmundje që mund të preki një numër të madh bimësh si barishtore ashtu dhe pemët frutore bërthamore, hardhinë, ullirin etj.

Sëmundja manifestohet me vyshkje dhe zverdhje të gjetheve, sidomos në fillim të verës dhe në disa pjesë të kurorës. Ecuria e sëmundjes mund të jetë e tipit akut dhe kronik. Në sindromën akute, gjethet në fillim vyshken lehtë dhe pastaj thahen brenda pak ditëve së bashku me degët që i mbajnë ato. Më vonë, bimët e prekura tentojnë të reagojnë duke nxjerrë thithakë nga baza ose pjesa e poshtme e trungut, por përfundojnë në tharje.

Sindroma kronike shfaq një ecure të sëmundjes shumë më të ngadaltë se sa e para. Në këtë rast gjethet zverdhjen, pastaj thahen dhe në fund rrëzohen. Në të dy rastet, simptomat shfaqen fillimisht në pjesët më të larta dhe pastaj përhapen më poshtë. Gjatë prerjes transversale të organeve drunore (degë ose trung), vihet re se indet kanë një ngjyrë gështenje ose kafe-zezë, që dallohet mirë në unazat e ksilemës, nën lëvore.

Simptomat shfaqen zakonisht në pranverë/Drejt fundit të verës, kur temperatura tenton të ulet, simptomat bëhen më pak të dukëshme për tu rishfaqur vitin pasardhës.

Masat e luftimit

Lufta kundër verticiliozës është shumë e vështirë. Ajo bazohet kryesisht në kritere preventive (parandaluese), duke evituar në rradhë të parë mbjelljen e pemtoreve të reja në toka që në vitet e mëparshme kanë qenë mbjellë me bimë të prekura nga kjo sëmundje. Në rastin e tokave të infektuara, ku nuk mund të pritet për 4-5 vite para mbjelljes së pemtores, mund të kryhet trajtimi me fungicide si Formalinë, Vapam ose Brumur metil.

Trajtimet mbi bimët e prekura mund të japin rezultate vetëm kur sëmundja është në fazat fillestare dhe ka prekur një pjesë të kufizuar të bimës. Para së gjithash nëqoftëse simptomat e sëmundjes nuk janë shumë të përhapura mund të tentohet të priten pjesët e sëmura të bimës dhe të dizinfektohet pjesa e prerë me fungicide. Nganjëherë dhe trajtimet me fungicide sistemikë si Benomyl, Tiofanat metil, Carbendazinë, mund të veprojnë si të aplikuara direkt në trungun e bimës ashtu dhe në tokë. Aplikimi në tokë është i preferueshëm mbi bimët shumë të reja dhe realizohet duke përdorur aparaturë që injektojnë me forcë fungicidin në brendësi të bimës.



Foto: Tharje e degëve nga verticilioza

NDRIÇIMI I ARGJEND

Stereum purpureum Pers.

Chondrostereum purpureum (Pers.; Fr.) Pouzar.

Simptomatologjia

Ndriçimi i argjendë mund të prekë pothuajse të gjithë pemët frutore (dardhën, mollën, ftoin, kumbullën, kajsinë, qershinë), por mbi pjeshë shfaqet me frekuencë të madhe duke provokuar dëme të rënda, ku bimët e prekura janë destinuar të thahen ose të japin prodhim të pakët.

Me termin ndriçim i argjendë, dallohet një kuadër simptomatologjik i veçantë tu nga ngjyrosja tipike e argjendë që marrin gjethet nga veprimi i agjentëve me natyrë biotike dhe abiotike. Është e nevojshme për këtë të dallohet një ndriçim i verës për shkak të temperaturave të larta dhe nuk sjell pasojë në vitalitetin e bimës; një ndriçim i argjendë i vontë nga fitofagët, i provokuar nga pickimet e akareve dhe hemipterëve; dhe një ndriçim i argjendë i hershëm parazitar, i shkaktuar nga *S. purpureum*.

S. purpureum prek pemë të ndryshme frutore. Simptomat karakteristike shfaqen mbi gjethe dhe dallohen tre stadi të evolucionit të sëmundjes :

- Në fazën e parë, gjethet në pjesën e sipërme marrin një ngjyrim metalik pa ndryshuar formën dhe zhvillimin e tyre.
- Në stadin e dytë të sëmundjes, gjethet me ngjyrë plumbi shfaqen të deformuara, të përdredhura, të përkulura dhe nganjëherë rreth fundit të verës me njolla të verdha-portokalli përgjatë bordurave.
- Në fazën e fundit gjethet mbeten shumë të vogla, me një ngjyrë të fortë argjendi dhe të mbledhura tufë mbi degë.

Indet drunore të trungut, të degëve dhe rrënjëve shfaqin nekroza, që në prerje rezultojnë të shpërndara në pjesë të kufizuara ose në të gjithë sipërfaqen e organit të prekur.

Në vitet e ardhëshme bimët e infektuara shfaqin një zhvillim gjithnjë e më të ngadalsuar dhe së fundi thahen.

Masat e luftimit

Lufta kundër *Stereum purpureum* bazohet kryesisht në kritere profilaktike. Këshillohet të kryhet krasitja sa më vonë të jetë e mundur dhe në ditë të ngrohta dhe të thata. Gjithashtu bimët e shëndosha duhet të krasiten gjithmonë përpara atyre të sëmura. Plagët nga shartimet, krasitjet ose të natyrave të tjera të shkaktuara në degë, duhet të dezinfektohen menjëherë me fungicide si Benomyl, Oxatinë. Po kështu duhet evituar shpërndarja e dozave të larta të plehrave azotike në bimët e infektuara nga ndriçimi i argjendë.

E një rëndësie të veçantë është kontrolli i periodik i pemtoreve ose i bimëve të tjera pyjore (sidomos plepit) për të kërkuar trupat frutorë të *Stereumit*, të cilët duhet të digjen. Në rastet kur duam të ringrejme pemtore, në toka ku gjendeshin më parë bimë të prekura nga ndriçimi i argjendë, është e nevojshme të bëhet paraprakisht dezinfektimi i tokës.

Ndërhyrjet kimike kurativa kundër ndriçimit të argjendë, nuk japin rezultate të kënaqëshme.




Foto: Prekje të rënda nga ndriçimi i argjende *S. Purpureum* si në kurorë ashtu edhe në masën drurorë

SEMUNDJET E PASVJELJES (BERTHAMORET)

KALBEZIMI KAFE

Monilinia laxa (Aderh. e Ruhl.) Honey

Monilinia fructigena (Aderh. e Ruhl.) Honey

Monilinia laxa është sëmundja më e rëndë që prek frutat e të gjitha bërbthamoreve në periudhat në afërsi të vjeljes, të magazinimit e të shitjes në disa raste më tepër se 50% të frutave pa dallim midis pjeshkës e nektarinës, midis kultivarëve të hershëm, mesatar apo të vonë.

Simptomat tipike të sëmundjes karakterizohen nga formimi i njollave me ngjyrë kafe-ulliri jo të thelluara, të cilat zmadhohen me shpejtësi. Në qendër të njollave formohet një myk i ngjeshur me ngjyrë gri në të hirtë duke pasur një diametër më të madh se 2-3 cm. Prania e mykut është shkaku kryesor i transmetimit të infeksionit me anë të kontaktit kur frutat janë afër njëri-tjetrit ku prania edhe e një fruti të vetëm të infektuar nga patogjeni kompromenton shitjen e të gjithë frutave të konfeksionuar.

Masat e luftimit

Principet e masave të luftimit kundra kësaj sëmundje janë të njëjta me ato të përshkuara për kalbëzimin e frutave në farore. Rezultate të mira japin trajtimet me Ronilan DF me dozën e përdorimit 1.5-2kg/ha, duke kryer një deri tre trajtime gjatë lulzimit dhe Bavistin DF me dozën 30-100gr/100 l.ujë.

MYKU GJELBER-KALTER

Penicillium expansum Link

Penicillium spp.

Kjo është një sëmun

dje që prek frutat vetëm në periudhën e pas-vjeljes ose që ruhen për një kohë të shkurtër. Mbi frutat që ruhen për një kohë të gjatë, sidomos në kumbull, shkalla e prekjes mund të kalojë edhe 10%.

Faktorët që favorizojnë shfaqjen e sëmundjes janë prania e plagëve (breshëri, vjelja, seleksionimi etj.) si dhe lagia e frutave.

Në qendër të pjesës së prekur nga sëmundja dhe në plasaritjet e formuara nga veprimi i patogjenit formohet shtresa e mykut në fillim me ngjyrë të bardhë dhe pastaj me ngjyrë të gjelbër-kaltër. Si rezultat i veprimit pektolitik të kërpudhës, tulli i frutit squlet në mënyrë të dukëshme.

Temperaturat optimale për zhvillimin e kërpudhës përfshihen midis 18-240C. Periudha e inkubacionit varet nga maturiteti i frutave dhe kushtet termike. Në frutat me pjekje të avancuar dhe temperaturë 20-250C, simptomat e para të sëmundjes shfaqen pas 36-48 orëve.

Burimi i infeksionit për këto patogjenë janë mbeturinat e frutave të kalbura (të bërbthamoreve dhe të faroreve).

SEMUNDJET VIRUSALE TE BERTHAMOREVE

Janë disa sëmundje virusale që i prekin bërbthamorët si:

NJOLLOSJA LINEARE E KUMBULLES

(Plum line pattern)

LIJA (SHARKA) E KUMBULLES (Plum pox)

Masat e luftimit kundra sëmundjeve virusale të pemëve frutore

Përdorimi i bimëve të “çertifikuara”

I gjithë aktiviteti që lidhet me prodhimin e bimëve të pastra nga viruset kalon nëpërmjet fazave të mëposhtme:

- Seleksionimi në fushë, me zgjedhjen e bimëve nga pamja e jashtme të shëndosha dhe me zhvillim të mirë vegjetativ e prodhues, si për kultivarët ashtu dhe për nënshartesat;
- Kontrolli sanitar i materialit të zgjedhur në fushë, me provat serologjike dhe me provat mbi bimët indikatorë (specie barishtore në sera, specie drunore në fushë). Në praktikë, provat serologjike janë të kufizuara dhe disponohen antiseret vetëm për disa viruse (Virusin e mozaikut të mollës, Virusin e njollosjes klorotike të gjetheve të mollës etj.). Provat mbi bimët test barishtore përdoren në shkallë të kufizuar,

për shkak të pamjaftueshmërisë së ndjeshmërisë. Përdoren sidomos provat mbi bimë indikatorë drunore në sera për sa i takon viruse që prekin aparatën vegjetativ dhe në fushë për ato viruse që shkaktojnë simptoma në fruta.

- Krijimi i "bërthamave të bazës", me klone që rezultojnë të shëndoshë ose të rishëndetsuar (nëpërmjet termoterapisë ose kulturës së meristemës së majës, apo nga përdorimi i kombinuar i të dyjave bashkë). Bërthama të bazës të ngjashme mund të krijohen nga 3 - 4 bimë për çdo klon, të rritura në sera me rrjetë të mbrojtura nga insektet dhe në tokë të sterilizuar;
- Krijimi i "fushave mëma bazë", në toka të sterilizuara paraprakisht dhe të izoluar nga zonat me pemë frutore. Nga bimë të fushave të tilla merret material i shëndoshë dhe i shpërndahet fidanishteve
- Përgatitja e "fushave të bimëve mëmë për prodhimin e materjaleve të certifikuar", përfshin mjelljen me kujdes nga çdo ent dhe fidanishte, nga ku merret material shumzues herë pas here i domosdoshëm për prodhimin regjtar të "bimëve të certifikua".

Programi vjetor mbrojtjes së pemëve bërthamore										
										
	Fillimi i gjelberimit sythave	Zbërthimi i sythave vegetativ	Diferencimi i sythave gjenerativ para hapjes	Ngjyrosja e sythave gjenerativ	Lulëzimi	Rënja e petaleve	Formimi i frutave /sperkatja e pare mrojtese	Spërkatjet pasuese gjatë verës	Paravjella	
Herbicidet	Rekomandohet Herbicid kundër barojave rezistente ndaj Glyko-fosfateve									
Fungicidet						Rekomandohet aplikimi i fungicideve me përmbajtje të Trifloxystrobin				
	Trajtimi dimëror me preparate bazë			Rekomandohen preparate me përmbajtje Flupiram, Tebucunazole						
Insekticidet					Aplikohet insekticid sistemik me përmbajtje Imidacloprid					
	Praktikohet insekticid Deltametrin kunder morrave , tripsave etj						Deltametrin			
							Praktikohet insekticid sistemik sipas nevojës			

Ky botim është përgatitur me ndihmën e MBPZHR-ARDP. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e organizatës KDC (Qendra Kosovare për Zhvillim), zbatuese e projektit, dhe nuk pasqyron pikpamjet e MBPZHR-së- ARDP-së.



KOSOVA DEVELOPMENT CENTER QENDRA KOSOVARE PËR ZHVILLIM

Address: Dëshmorët e Lirisë nr.135 Gjakovë-Kosovë
Tel: +383 38 724 499 Email: kdc.gjakov@yahoo.com
www.kdc-kosova.org